



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 01.08.2023
Ref. KM -242 /23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.7/ 01 mars 2019, Prishtinë), nenin 14 paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-019 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.02/L-8 për Verërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.13/1 shtator 2011, Prishtinë), nenin 13 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.04/2014 për caktimin e kriterëve për marrjen e mostrave, analizën e mushtit, verës dhe prodhimeve tjera nga rrushi dhe vera si dhe vlerësimin organoleptikë të verës, duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.4, nenin 15 Shtojcën 11 të Rregullores (QRK)-NR.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

V E N D I M

Për emërimin e Komisionit Ri – vlerësues të verërave të prodhuara nga vjelja e vitit 2021 dhe 2022 nga “Wineplant” sh.p.k.

1. Emërohet Komisioni, në përbërje prej shtatë (7) anëtarësh:

- 1.1. Sadik Korenica, kryesues,
- 1.2. Tasim Bajrami, sekretar i komisionit,
- 1.3. Eshref Kasapi, anëtar,
- 1.4. Fejzullah Berisha, anëtar,
- 1.5. Bejtulla Haxhimurati, anëtar,
- 1.6. Nesim Morina, anëtar, dhe
- 1.7. Ylber Kuçi, anëtar.

2. Nëse ndonjëri anëtar i komisionit nga pika 1 e këtij Vendimi mungon, atëherë anëtar rezervë caktohet Ismalj Vehapi, anëtar.

3. Komisioni obligohet të bëj ri - vlerësimin zyrtar për katër tipe të verës të prodhuar nga vjelja e vitit 2021 dhe vjelja e vitit 2022, të mostrave të verës duke u bazuar në nenin 21, paragrafi 21.1 dhe 21.2 të Ligjit Nr.04/L-019 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.02/L-8 për Verërat dhe Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.04/2014 për caktimin e kriterëve për marrjen e mostrave, analizën e mushtit, verës dhe prodhimeve tjera nga rrushi dhe vera si dhe vlerësimin organoleptikë të verës.

4. Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi obligohet të bëj vlerësimin organoleptikë të tipeve të verës më datën 04 Gusht 2023, e Premte, duke filluar në ora 10⁰⁰ në Zyrat e Departamentit të Vreshtarisë dhe Verëtarisë në Rahovec.

5. Anëtarët e Komisionit nga pika 1 të këtij vendimi për punën e kryer do të kompensohen veç e veç nga pesëdhjetë euro (50 €), sipas kërkesës nga kompania prodhuese e verës "Wineplant" sh.p.k. Prizren, për rivlerësim zyrtar për katër tipe të verës të prodhuar nga vjelja e vitit 2021 dhe vjelja e vitit 2022, si vijon:

1.1. "Wineplant" sh.p.k.

1.1.1. Merlot reserve – viti i vjeljes 2021, sasia HI

1.1.2. Merlot – viti i vjeljes 2022, sasia 37 HI

1.1.3. Aromera – viti i vjeljes 2022, sasia 17 HI, dhe

1.1.4. Rizling – viti i vjeljes 2022, sasia 8 HI.

6. Komisioni nga pika 1 e këtij Vendimi ka për detyrë që të hartoj raport të detajuar pune me shkrim për ministrin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

7. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij Vendimi.

8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi t'i dërgohet:

- Anëtarëve;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Vreshtarisë dhe Verëtarisë, dhe
- Arkivit.

